

A black and white illustration showing three stylized human figures interacting with large puzzle pieces. One figure stands on a piece, reaching up to place another. Two other figures stand on the ground, one pointing towards the structure. The background is a textured, light grey wash.

Qendra për hulumtime dhe
bashkëpunim rajonal
Studiosurum

Shkup, vitin 2011

**PJESËMARRJA EFEKTIVE
POLITIKE E BASHKËSIVE (MË)
TË VOGLA NË VETËQEVERISJEN
LOKALE NË MAQEDONI:**

*Implikime dhe
rekomandime*

PËRMBAJTJA

HYRJA	3
I. BAZA	4
II. E DREJTA E Pjesëmarrjes efektive politike	4
E drejta e pjesëmarrjes efektive politike të bashkësive (më) të vogla në vetëqeverisjen lokale në Maqedoni.....	5
Jodiskriminimi.....	6
Përfaqësimi proporcional.....	7
Decentralizimi.....	8
III. REKOMANDIMET	9
BIBLIOGRAFIA	11

M-r Biljana KOTEVSKA

M-r Kumjana NOVAKOVA

Pjesëmarrja efektive politike e bashkësive (më) të vogla në
vetëqeverisjen lokale në Maqedoni: Implikime dhe rekomandime

Botues: Qendra për hulumtime dhe bashkëpunim rajonal “Studiorum”,
Shkup

Për botuesin: m-r Neda Milevska-Kostova, drejtor ekzekutiv

Përkthim në gjuhën shqipe: Emilija Janakieva

Design: KOMA, Shkup

Shtyp: Media-Konekt, Shkup

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

352:342.57-054.57(497.7)

KOTEVSKA, Biljana

Pjesëmarrja efektive politike e bashkësive më të vogla etnike në
vetëqeverisjen lokale në Republikën e Maqedonisë : ndikimi i
marrëveshjes kornizë të Ohrit / [Kotevska Biljana, Novakova Kumjana].

- Shkup : Studiorum, 2011. - 16 стр. ; 23 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 15

ISBN 978-608-65392-4-5

1. Novakova, Kumjana [автор]

а) Локална самоуправа - Малцинска партиципација - Македонија

COBISS.MK-ID 90113546

HYRJA

Pjesëmarrja efektive politike e grupeve (më) të vogla në proceset e vendimmarrjes në Maqedoni, në nivel qendror si edhe në nivel lokal, në lidhje me çështjet që u referohen në mënyrë direkt, ngrit brengesa dhe gjithashtu paraqitet edhe si temë e shpeshtë të diskutimit për dhe në organizatat ndërkombëtare, ekspertët lokal dhe KQ, akademikë dhe analitikantë. Gjeneralisht, në kontekst të së drejtës së pjesëmarrjes politike, standardet internacionale për të drejtat e njeriut sugjerojnë se pjesëmarrja politike (qasja deri te, dhe pjesëmarrja e plotë e minoriteteve në proceset e vendimmarrjes), paraqet element kyç në mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të bashkësive, si edhe për ruajtjen e identiteteve të tyre dalluese kulturore dhe/ose të tjera.

Megjithatë, korniza konsociale politike i vënë si rezultat i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MKO) pas konfliktit nga viti 2001, si edhe përmes dispozitave të tij kushtetuese dhe juridike, shumë pak kontribuojnë në atë kontekst - fuqia, *de facto* është ndarë midis dy grupeve më të mëdha etnike, maqedonasit etnikë dhe shqiptarët etnikë, duke i përjashtuar bashkësitë (më) të vogla etnike nga proceset politike.

Më shpesh burimi i cituar të përjashtimit, dhe nga kjo edhe të diskriminimit, është pragu nga 20% i sjellë nga MKO-ja i cili është vënë si parakusht minimal për të drejtën e bashkësive etnike të gëzojnë në dispozitat kyçe të cilat mundësojnë pjesëmarrje efektive; përdorim të gjuhës, të drejtën e arsimimit të lartë në gjuhën amëtare ose thjesht përfshirje në format e ndryshme të proceseve të konsultimit përfaqësojnë mekanizma për pjesëmarrje në administratën publike dhe në trupet gjyqësore e të tjera në nivel lokal.

Pengesa kushtore/ juridike shkon së bashku me format më të përsosura dhe më pak të dukshme, nganjëherë edhe delicate dhe sidoqoftë lartë të komplikuar të përjashtimit, si për shembull, deficitin demokratik, kultura e ulët politikore, mungesa e vullnetit politik, tempoja e ngadaltë të reformave demokratike, etj. Pastaj, ende ekziston mungesa e përgjithshme të kuptimit nga ana e dy elitave politike dhe gjeneralisht nga shoqëria, se procesi plotësisht përfshirës politik dhe pjesëmarrja e grupeve të minoriteteve në jetën politike dhe në punët publike nuk do t'u shërbejë vetëm grupeve të minoriteteve, por edhe shoqërisë në përgjithësi.

Deri në cilën masë implementimi i MKO-së e zmadhon pjesëmarrjen efektive politike të grupeve (më) të vogla etnike në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal në Maqedoni?

Ky raport është përgatitur mbi bazë të studimit empirik për *Pjesëmarrjen efektive politike të bashkësive (më) të vogla etnike në vetëqeverisjen lokale në Republikën e Maqedonisë: Ndikimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit* (në tekstin e mëtejshëm: Studimi bazë), duke e hulumtuar ndikimin e MKO-së dhe të dispozitave kushtetuese dhe juridike të cilat dalin nga I njëjti për pjesëmarrjen efektive politike të grupeve (më) të vogla etnike në nivel të komunave në Maqedoni.¹ Studimi ofron analizë të implementimit të MKO-së me theks të

¹ Teksti i plotë i studimit bazë mund ta gjeni këtu: www.studiorum.org.mk.

veçantë të pjesëmarrjes efektive politike të grupeve më të vogla etnike dhe rrjedhimisht jep rekomandime për diskutim të mëtejshëm në kornizat e bashkësisë akademike.

Ky raport i përmbledh përfundimet themelore në fushën e antidiskriminimit, përfaqësimit të drejtë dhe decentralizimit si fusha të cilat me MKO reformohen në masë më të madhe, duke propozuar rrjedhimisht rekomandime me qëllim zhvillim i pjesëmarrjes efektive politike të bashkësive (më) të vogla etnike.

I. BAZA

Termi bashkësi (më) të vogla etnike vihet në legjislativën e vendit si rezultat i reformave juridike dhe politike pas nënshkrimit të Marrveshjes Kornizë të Ohrit me të cilën iu vë fund konfliktit të vitit 2001; termi përdoret për bashkësitë të cilat numerikisht janë më pak se 20% nga populli i përgjithshëm i shtetit. Sipas regjistrimit të popullsisë nga viti 2002, përveç dy bashkësive më të mëdha – maqedonasit dhe shqiptarët, në Maqedoni jentojnë (5) bashkësi (më) të vogla dhe “të tjerë”, përkatësisht turq (3,85%), romë (2,66%), serbë (1,78%), boshnjakë (0,84%), vlehë (0,48%) dhe 1,04% i përkasin kategorisë “të tjerë”.²

Ndryshimet dhe plotësimet e Kushtetutës së vendit dhe të ligjeve të saj e sigurojnë zbatimin e dispozitave të MKO-së, të cilat, zbatojnë të drejta të veçanta për minoritetet etnike dhe gjuhësore të cilat e mbikalojnë numrin nga 20% nga populli i përgjithshëm të vendit në nivel qendror, ose në komunën në fjalë në nivel local. Pastaj, ekzistojnë dispozita të veçanta të cilat i rregullojnë të drejtat e minoriteteve të cilat janë nën 20% nga populli i përgjithshëm të vendit ose të komunës së caktuar.

Edhe përkrah këtyre mungesave, ende nuk është humbur gjithçka nëse në procesin e implementimit të MKO-së respektohen parimet ekzistuese për përforcimin e grupeve të minoriteteve, një nga ato është e drejta e pjesëmarrjes (efektive) politike, veçanërisht në rastin e minoriteteve (më) të vogla etnike. Ky studim propozon disa rekomandime përmes të cilave mund të ndikohet në atë drejtim.

II. E DREJTA E PJESËMARRJES EFEKTIVE POLITIKE

E drejta e pjesëmarrjes efektive politike

Themelet kryesore mbi të cilat është vënë mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të minoriteteve janë parimet e jodiskriminimit dhe parimi për mbrojtje dhe promovim të identitetit të grupeve të minoriteteve.

E drejta e pjesëmarrjes e cila siguron pjesëmarrje efektive politike në nivel kolektiv është një kategori relativisht të re juridike dhe politike, e cila shpesh llogaritet si e drejta e “gjeneracionit

2 1.297.981 maqedonas, 509.083 shqiptarë, 77.959 turq, 53.879 romë, 35.939 serbë, 17.018 boshnjakë, 9.695 vlehë dhe 20.993 „të tjerë“. Regjistrimi 2002 – Libri X: populli i përgjithshëm sipas përkatësisë etnike, gjuhës amtare dhe religjisë. Enti shtetëror i statistikës. Ueb-faqja oficiale I Entit shtetëror i statistikës. <<http://www.stat.gov.mk/publikacii/knigaX.pdf>>. E vizituar për here të fundit më: 29 prill vitin 2011.

të tretë”. Gjeneralisht, e drejta e pjesëmarrjes, me theks të pjesëmarrjes efektive politike, d.m.th. pjesëmarrja e cila ka ndikim mbi rezultatet e proceseve të vendimmarrjes në punët publike ndërkombëtare, zhvillohet në vitet 1990. Koncepti nuk përfshin vetëm pjesëmarrje në trupet ligjdhënëse, por edhe pjesëmarrje në punët publike.³

Qëllimi kryesor me të drejtën e pjesëmarrjes efektive siç është shënuar në Dokumentin e Kopenhagenit të OSBE (paragrafi 35), Deklaracionin e KB-së për të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare, etnike, religjioze dhe gjuhësore [neni 2(2) dhe 3], me garanci nga Konventa kornizë për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare (neni 15), është që të sigurohet qasje për grupeve të minoriteteve ndaj proceseve të sjelljes së vendimeve të ndryshme, në të gjitha nivelet e udhëheqjes, pa diskriminim. Ashtu, e drejta e pjesëmarrjes politike të minoriteteve ka për qëllim kryesor që ta mbrojë, afirmojë dhe promovojë identitetin e minoriteteve, dhe parimi i jodiskriminimit është koncept kyç për zbatimin universal të sistemit të të drejtave të njeriut.

E drejta e pjesëmarrjes efektive politike të bashkësive (më) të vogla etnike në vetëqeverisjen lokale në Maqedoni

Komiteti Këshilldhënës i Konventës kornizë për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare tregon se ekzistojnë dallime të mëdha midis, nga njëra anë, bashkësisë shqiptare, e cila merr pozitë qendrore në jetën publike të vendit dhe ka rol të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes, dhe nga ana tjetër grupeve (më) të vogla etnike, të cilat kanë mekanizma të kufizuara për qasje ndaj proceseve të vendimmarrjes, duke e krijuar ndjenjën e përjashtimit midis tyre në jetën publike, por gjithashtu edhe nga MKO dhe nga procesi i zbatimit të tyre.⁴ Përveç kësaj, ky trup thekson se zbatimi i MKO-së nuk duhet udhëhequr drejt kufizimeve të të drejtave të grupeve (më) të vogla etnike, por me atë jipen rekomandime jo vetëm për nevojën e përfshirjes së tyre në dialogun interkulturore dhe në zbatimin e parimit të përfaqësimit proporcional, por edhe për distribucionin e drejtë të burimeve, qasjen deri te mediave, të drejtën e arsimimit në gjuhët e minoriteteve, përfaqësimin e trupeve juridike dhe gjykatat, etj.

Gjeneralisht, rekomandimet sugjerojnë se qeveria duhet t'i zmadhojë përpjekjet e saj me qëllim që të sigurohet përfaqësim të drejtë të bashkësive (më) të vogla etnike në sferën publike, veçanërisht në administratën publike. Komiteti Këshilldhënës rekomandon që të merren masa speciale të cilat do të kontribuojnë në luftën kundër përjashtimit dhe marginalizimit social të bashkësisë rome, me qëllim sigurimi i pjesëmarrjes së tyre në sferën publike. BE i ndjek rekomandimet e njëjta, sepse Raporti për zhvillimin e Komisionit Evropian nga viti

3 Për më shumë detaje, shiheni tekstin e plotë të Studimit bazë, të cilin mund ta gjeni në: www.studiorum.org.mk.

4 Në vitin 2002 nga gjithsej 58,927 të punësuarit në administratën shtetërore - 14,7% ishin shqiptarë, 1,4% turq, 0,5% vlehë, 2,1 serbë, 0,6% romë, 0,3% boshnjakë. Në pajtim me të dhënat statistike, në dhjetor 2004 numri i të punësuarit në administratën shtetërore është 56,871 nga të cilët 18,1% janë shqiptarë, 1,6% turq, 0,6% vlehë, 2,1% serbë, 0,7% romë, 0,3% boshnjakë dhe 1,2% të tjerë. Ragaru, N. The Former Yugoslav Republic of Macedonia: Between Ohrid and Brussels. in Batt, Judy. (ed.). Is There an Albanian Question. Chaillot Paper, 107, 2008: 41 - 56.

2010 thotë se përfaqësimi i bashkësive (më) të vogla, veçanërisht bashkësia turke dhe rome në sektorin qytetar mbetet në nivel të ulët.

Edhe nga pavërsia, në Maqedoni shihet një tendencë të krijimit të përfaqësimit të përsosur të kornizës juridike për mbrojtjen e minoriteteve, dhe nga këtu vjen edhe pozita e minoriteteve. Edhe pse termet ‘minoritet’ dhe ‘e drejtat e minoriteteve’ nuk janë shpërndarë gjerësisht në diskursin politik dhe juridik, standardet nga puna në terren u vlerësuan dhe përfaqësuan nga elitave kombëtare politike si lartë progresive madje edhe gjatë vitit 2001. Këtë diskurs e shënon raporti i parë shtetëror i Konventës kornizë (vitin 2003), sipas të cilit Maqedonia është shtet me nivel më të lartë të zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të minoriteteve, mbi bazë të tolerancës thellë të depërtuar.

Siç mund të vërehet nga shënimet tona empirike, bashkësia akademike në Maqedoni mendon se, në nivel normativ, Maqedonia ka arritur standarde të larta për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve si edhe sistem mirë i zhvilluar institucional për të njëjtat, veçanërisht pas ndryshimeve dhe plotësimeve të Kushtetutës në vitin 2001. Ashtu, sipas disash, MKO në të vërtet ofron një kornizë shumë liberale dhe qytetare, e cila jep mundësi për procese inkluzive e vendimmarrjes përmes qasjes së saj individual, sepse qytetarët janë ato që i kanë të drejtat dhe prandaj qytetarët të cilët u përkasin bashkësive etnike nuk mund të përfshihen në procesin e vendimmarrjes. Por, disa mendojnë se pragu nga 20% ndikon mbi tërë implementimin e të drejtave të bashkësive etnike, që ato të marrin pjesë në mënyrë efektive në udhëheqjen. Në fund, një nga çështjet kyçe e cila ende ka ndikim negativ është përfshirja e grupeve (më) të vogla etnike nga nënshkrimi i MKO-së.

Zbatimi i MKO-së është në kundërshtim me kornizën juridike dhe normative, që, sipas intelektualëve dhe ekspertëve lokal vlerësohet si problematik.

Në nivel lokal të vetëqeverisjes, shumica e të anketuarve e ndajnë të njëjtin mendim se shteti ka shënuar një mospësuks në zbatimin e dispozitave të MKO-së në lidhje me të drejtat e minoriteteve. Disa nga të anketuarit nga administrata e pushtetit lokal edhe kanë treguar rezistencë ndaj përmendimit eksplicit të të drejtave të minoriteteve. Rezistenca e këtillë gjithashtu ekziston mes disash nga të anketuarit të shoqërisë qytetare, i shfaqur përmes argumentit të përgjithshëm se edhe pse të drejtat e minoriteteve janë të rëndësishme, edhe më e rëndësishme është punësia e qytetarëve – duke e pohuar qartësisht nevojën nga renditja e të drejtave të minoriteteve në radhë të parë dhe nga zhvillimi i projekteve të cilat do t'i lehtësojnë ndryshimet në kulturën politike. Rezistencë e pafshehur ndaj përdorimit të termit ‘minoritet’ gjithashtu ekziston edhe te shqiptarët të cilët janë në pozita kyçe në komuna të posaçme.

Ç'u referohet përmirësimeve të përgjithshme në fushën e të drejtave të minoriteteve dhe pozitës së bashkësive (më) të vogla pas MKO-së, shumica e përfaqësuesve të KQ-së nuk shohin përmirësim të rëndësishëm të pozitës së bashkësive (më) të vogla etnike, ndërsa disa i karakterizojnë si humbës në tërë situatën. Pastaj, të punësuarit në KQ kanë kundërshtime serioze për vetë natyrën e MKO-së (nga të cilat karakteristika më e përgjithshme është se ajo

është një marrëveshje binacional e cila promovon shtet binacional, ose se është masrëveshje midis maqedonasve dhe shqiptarëve), për pragun nga 20%, për zbatimin e tij jo të drejtë, për përbërjen e bashkësive (më) të vogla etnike për shkak të fokusimit mbi një grup etnik, etj. Por, disa nga të anketuarit i theksuan përparësitë e MKO-së për bashkësitë (më) të vogla, si për shembull numri i zmadhuar i përfaqësuesve në nivel qendror dhe lokal, numri i zmadhuar i të punësuarit në sektorin publik dhe veçanërisht përparësitë për bashkësinë e romëve e cila është objekt i diskriminimit dhe marginalizimit të pandërprerë dhe vazhdueshëm (në vend të punësimit tradicional të anëtarëve të bashkësisë së romëve si higjienistë, tani numri i punësimeve të romëve në pozita të shërbimit qytetar zmadhohet).

Jodiskriminimi

Elitat politike në Maqedoni për një kohë të gjatë i parashohin masat dhe aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren me qëllim që të sigurohet zbatim i plotë të parimit të barazisë, edhe përkrah rëndësisë së saj kryesore.

Korniza juridike për mbrojtjen nga diskriminimi në Maqedoni është vënë nëpërmjet Kushtetutës dhe ligjeve, ndërsa ratifikimi i MKO-së nuk ka sjellë asnjë ndryshim të rëndësishme në këtë fushë. Kushtetuta përmban dispozitë për barazinë e të gjithë qytetarëve pa dallim nga gjinia, raca, ngjyra, burimi kombëtar dhe social, bindjet politike dhe religjioze, statusit e pronësisë apo social (neni 9). Avokati i popullit e siguron mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur të njëjtat shkelen nga organet shtetërore administrative dhe nga organizatat të cilat kanë autorizim publik (neni 77 dhe amandamenti XI i nenit 77). Ligji për avokatin e popullit është sjellë vitin 1997, por ai nuk fokusohet në mënyrë përkatëse në parandalimin e diskriminimit, si edhe në mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve.

Ndryshimet në kornizën juridike për mbrojtjen nga diskriminimi në vitin 2010 kanë rezultuar me zbatimin e ligjit të parë të veçantë për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Edhe përkrah shumë kritikave dhe mungesave e këtij ligji, shumica e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore dhe nga shoqëria qytetare e kanë pranuar këtë tekst si hapi i parë ndaj ndërtimit të bazës së fortë për mbrojtjen nga diskriminimi. Komisioni për mbrojtjen nga diskriminimi është formuar në pajtim me këtij ligji, që e përfaqëson trupin e parë të barazisë në Maqedoni.

Megjithatë, Maqedonia gjeneralisht nuk ka një strategji të drejtuar për jodiskriminimin dhe barazinë, edhe përkrah mungesës së hyrjes holistike dhe strategjike ndaj promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Edhe përkrah rëndësisë së dukshme dhe nevojës nga sjellja e Planit Kombëtar Aksional për të drejtat e njeriut (duke e përfshirë edhe jodiskriminimin), dokumenti i këtillë nuk është as temë e diskutimit.

Analiza e të dhënave tregon se shumica e të anketuarve nga institucionet shtetërore, komunat dhe nga KQ, si edhe nga bashkësitë e shumicave dhe minoriteteve – e pohojnë pozitën se në Maqedoni dhe/ ose në komunat e saj nuk ka diskriminim. Disa nga të anketuarit mendojnë

se përjashtimi shpesh është rezultat i kualifikimeve jopërkatese, dhe jo të diskriminimit, ndërsa të tjerët janë të mendimit se diskriminimi, si çështje, është imponuar nga donatorët dhe se ai nuk është diçka që përfaqëson problem real në Maqedoni. Një numër të vogël të të anketuarve të cilët kanë pohuar se ekzistojnë raste të diskriminimit e lidhin të njëjtin me anëtarët e bashkësisë së romëve. Baza më e shpesh për rastet e diskriminimit direkt mendohet se është diskriminimi etnik dhe partiak, ndërsa diskriminimi indirekt lidhet me prapësin nga 20%.

Përfaqësimi i drejtë

Instrumenti i mekanizmit proporcional është masa kyçe jo vetëm për përfaqësimin përkatës të bashkësive (më) të vogla, por gjithashtu është masa gjenerale për parandalimin e diskriminimit. Mekanizmi i përfaqësimit proporcional ka pasur rëndësi qendrore gjatë negociatave për MKO, sepse statistika tregon se gjatë viteve 1990, numri i shqiptarëve [si edhe numri i bashkësive (më) të vogla] të punësuar në administratën publike ka qenë shumë i vogël, dhe prandaj një pjesë e madhe e ankesave të shqiptarëve janë rezultat i përjashtimit të tyre nga shërbimi publik.⁵ Si rezultat i asaj, MKO për herë të parë e ka prezantuar këtë mekanizëm, dhe zbatimi i tij u mundësua përmes një seri të ndryshimeve komplekse në sistemin juridik si pasojë e amandamentit VI të Kushtetutës, më saktësisht përmes ndryshimeve e disa ligjeve – ligji për gjykatat, ligji për prokurorin publik, ligji për marrëdhëniet pune, ligji për ndërmarrjet publike, ligji për arsimin themelore, ligji për arsimin e mesme, ligjin për standardet e nxënësve dhe studentëve, ligji për avokatin e popullit dhe ligji për nëpunësit shtetërore.

Siç u tregua edhe në Studimin themelor, një numër të vogël të të anketuarve mendojnë se MKO respektohet në kushtet e përfaqësimit të drejtë, dhe një pjesë e madhe prej tyre mendojnë se nuk është arritur një zhvillim të mjaftueshëm në zbatimin e këtij parimi, veçanërisht në organet e komunave dhe në ndërmarrjet shtetërore dhe publike. Shumë nga të anketuarit shënojnë se zbatimi jokonzistent i parimit gjeneralisht në rastin e bashkësive (më) të vogla etnike, i cili zakonisht është përkrahur me argumentin se nuk ekziston arsim të mjaftueshëm profesional të përfaqësuesit të punësuar. Përkrah asaj, pjesa më e madhe e të anketuarve e theksojnë tregtimin politik dhe/ ose punësimin mbi bazë të kriterëve të lidhjes, jo vetëm në nivel qendror por edhe në lokal, si faktor i madh që e vë në rrezik zbatimin e suksesshëm. Megjithatë, disa, si shkak kyç për zhvillimin e ngadalëshëm në arritjen e përfaqësimit proporcional si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror, e shohin situatën e keqe ekonomike të shtetit dhe vullnetin e vogël politik ose mosekzistimin e konsenzusit për të njëjtën.

5 Për më shumë informata mund ta shihni Studimin bazë, të cilën mund ta gjeni në: www.studio-rum.org.mk

Decentralizimi

MKO, përkundrazi nga marrëveshjet e tjera paqe në vendet e tjera të ish Jugosllavisë e pohojnë rregullin e përgjithshëm për grupet e ndryshme etnike (Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë), nuk u ka dhënë as autonomi territoriale, as kulturore grupeve të saj etnike. Në vend të asaj MKO parasheh se sigurimin e përfaqësimit proporcional dhe të sovranitetit mbi çështjet të cilat në mënyrë direkte u referohen grupeve duhet të arrihet përmes procesit të decentralizimit, ose përmes kompetencave më të larta të mekanizmave për udhëheqjen lokale.

Si rezultat i kësaj, ligjet të cilat janë sjellë si pjesë e MKO-së kërkojnë transfer të kompetencave të cilat u referohen karakterit fundamental të komunës dhe atyre të cilat ndikojnë mbi bashkësitë, si për shembull kultura, përdorimi i gjuhëve, për stemën dhe flamurin duhet shumica dytësore nga shumica e këshilltarëve dhe përfaqësuesve të bashkësive (më) të vogla etnike së bashku. Biber, f. 34 (Biber, p. 34). Ky lloj i rregullimit ua siguron të drejtën e vetosë në sjelljen e vendimeve të caktuara edhe grupeve (më) të vogla etnike edhe popullit maqedonas, nëse gjenden në pozitë të minoritetit në njësinë e caktuar lokale.

Procesi i decentralizimit në lidhje me organizimin territorial të vendit ka treguar se është një nga reformat më të dëmshme të cilat dalin nga MKO, ku pjesa më e madhe e intelektualëve e vlerësojnë edhe si kërcënim më të madhe për stabilizimin e vendit pas konfliktit të vitit 2001. Disa çështje të cilat dallohen nga ky proces i referohet faktit se negociacionet ishin plotësisht të mbyllura për qytetarët dhe ekspertët, e bashkësitë (më) të vogla ishin përfshirë në procesin edhe përkrah faktit se kufijtë e tyre të komunave ndryshohen dhe prandaj vendimet ndikojnë në mënyrë direkte mbi jetën e tyre; bashkimi ndërkombëtar e legjitimizon tregtimin politik si mjet për sjelljen e vendimeve, por nuk ka arritur të bëjë presion për transparencë dhe përgjegjshmëri rreth procesit, dhe me atë t'i legjitimizojë marrëveshjet partiake dhe etnike.

Ajo i fundit ishte një hap prapë në pozitën dhe ndjenjën e përfshirjes së bashkësive (më) të vogla etnike, sepse edhe përkrah karakterit të negociacioneve partiake, partitë në të vërtetë i përfaqësonin dy grupet më të mëdha etnike: maqedonasit etnikë dhe shqiptarët etnikë.

Shumë intelektualë vërejnë se ndryshimin e kufijve të komunave dhe numri mbi bashkësitë (më) të vogla etnike si edhe shumica e maqedonasve në komuna të caktuara ka krijuar ndjenjë e “humbjes” së truallit dhe ajo rezultoi me projekte të paqarta për ndërtimin e nacionalitetit në nivel lokal, përfaqësimin e tepërmase të simboleve të komunës dhe fushatave për ngritjen e ndërgjegjes për identitetin nga ana e liderëve. (Biber, f. 35) (Biber, p. 35).

III. REKOMANDIMET

1. Në përgjithësi, ekziston nevojë nga zbatimi i hyrjes më strategjike gjeneralisht ndaj të drejtave të njeriut dhe veçanërisht ndaj të drejtave të minoriteteve. Me atë, rekomandohet që shteti të fillojë një proces të gjerë konsultativ për zbatimin e mundshëm të Planit Aksional për të drejtat e njeriut me qëllim që të marrin pjesë dhe t'i artikulojnë problemet me të cilat përballohen bashkësitë e tyre, dhe shkeljet e të drejtave të anëtarëve të tyre.
2. Në këtë mënyrë, zbatimi i trupit i orientuar ndaj hulumtimit dhe përmbledjes së të dhënave në fushën e të drejtave të njeriut do të krijonte të dhëna të cilat themelohen mbi analizën e politikës, të raporteve dhe më rëndësi më të madhe, të rekomandimeve. Krijimi i qendrës për të drejtat e njeriut në bashkësinë akademike, i cili do të përfshinte ekspertë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut dhe ekspertë mund ta ketë rolin e gjeneratorit të analizave të themeluara mbi informatat.
3. Më saktësisht, fushatat për ngritjen e ndërgjegjjes të cilat janë drejtuar ndaj dy grupeve dominante etnike, si edhe ndaj bashkësive (më) të vogla etnike për përparimet nga pjesëmarrje efektive politike të atyre të fundit për çështjet që u referohen në mënyrë direkte, por gjithashtu edhe për/ në punët publike, duhet të merren parasysh me qëllim që të kontribuohet ndaj vënies së të drejtave të minoriteteve në plan të parë.
4. Duhet të shqyrtohen dhe diskutohen mënyrat më inkluzive dhe më inovative të përfshirjes së qytetarëve, veçanërisht të qytetarëve që u përkasin bashkësive më të vogla etnike, në nivel lokal të komunikimit, me qëllim që të ngritet ndërgjegjja për mundësitë që ato të përfshihen në proceset e vendimmarrjes në kuadrat e komunave të tyre.
5. Administrata shtetërore, veçanërisht administratën shtetërore në nivel lokal, duhet të jetë profesionale, e jo aktive në mënyrë politike, me qëllim që administrata publike të bëhet shërbimi i qytetarëve e të bashkësive, e jo shërbim i partive politike. Ajo i fundit do ta zmadhojë pjesëmarrjen politike deri në shkallë të caktuar.
6. Administrata shtetërore, veçanërisht administratën shtetërore në nivel lokal, duhet t'i përforcojë kapacitetet për planifikimin e burimeve njerëzore, si edhe ta zhvillojë, implementojë dhe mbikëqyrë zbatimin e kriterëve të punësimit. Në rast të punësimeve të reja, dhe me qëllim arritje e përmbajtjes etnikisht të balancuar të administratës shtetërore, gjithashtu duhet të respektohen standardet dhe kriterët e profesionalizmit gjatë punësimeve.
7. Çështjet për të cilat grupet (më) të vogla etnike konsultohen dhe përfshihen duhet të jenë ekstenzive dhe ta kalojnë përdorimin lokal të të drejtave të gjithëve dhe administrimit lokal dhe t'i përfshijnë proceset e vendimmarrjes në nivel lokal, veçanërisht në nivel qendror.

8. Liderët e bashkësive (më) të vogla etnike duhet të përfshihen më shumë në bashkësitë e tyre etnike dhe të organizojnë fushata për ngritjen e ndërgjegjjes midis anëtarëve të tyre në lidhje me të drejtën e pjesëmarrjes politike që ata e kanë.
9. Liderët e bashkësive (më) të vogla më shumë duhet të aktivizohen në bashkësitë e tyre dhe të kycin partneritete me institucionet shtetërore me qëllim që të organizohen fushatat për ngritjen e ndërgjegjjes për nevojën nga zhvillimi i kapaciteteve profesionale të anëtarëve të grupit.

BIBLIOGRAFIA

1. Bieber, F. (ed). "Powersharing and the Implementation of the Ohrid Framework Agreement", Friedrich Ebert Stiftung, Skopje, 2008.
2. Ragaru, N. The Former Yugoslav Republic of Macedonia: Between Ohrid and Brussels. in Batt, Judy. (ed.). Is There an Albanian Question. Chaillot Paper, 107, 2008: 41 – 56.
3. UN General Assembly, International Covenant on Civil and Political Rights, 16 December 1966, United Nations, Treaty Series, vol. 999, p. 171, UN Web page, <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/3ae6b3aa0.html>> Last accessed: 15 октомври, 2011 година.
4. Генерално собрание на ОН, Декларација за правата на лицата кои припаѓаат на национални, етнички, религиозни и лингвистички малцинства, усвоена на 18 декември, 1992 година, GA RES 47/135, достапно на: <<http://www2.ohchr.org/english/law/minorities.htm>> последно пристапено: 23 октомври, 2011 година.
5. Европска комисија, Република Македонија – извештај за напредок од 2010 година, Брисел, 9 ноември, 2010 година. <http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/mk_rapport_2010_en.pdf> последно пристапено: 23 октомври, 2011 година.
6. Конференција за безбедност и соработка во Европа, документ од Копенхашкиот состанок за Конференцијата на човековата димензија од ОБСЕ, 5-29 јуни, 1990 година, Копенхаген, достапно на: <<http://www.osce.org/odihr/elections/14304>> Последно пристапено: 23 октомври, 2011 година.
7. Попис 2002 – Книга X: вкупно население според етничкаприпадност, мајчин јазик и религија. Државен завод за статистика. Официјална веблокација на Државниот завод за статистика. <<http://www.stat.gov.mk/publikacii/knigaX.pdf>>. Последно пристапено на: 29 април 2011 г.
8. Собрание на Република Македонија, измени на Уставот на Република Македонија, усвоени на 16 ноември, 2001 година, 07-3795/0, достапни на: <http://www.sobranie.mk/en/WBStorage/Files/Ustav_na_RM.pdf> Последно пристапено: 23 октомври, 2011 година.
9. Совет на Европа, Рамковна конвенција за заштита на националните малцинства, усвоена на 1 февруари, 1995 година, достапно на: <<http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/html/157.htm>> Последно пристапено: 23 октомври, 2011 година.

10. Совет на Европа: Секретаријат за рамковната конвенција за заштита на националните малцинства, советодавен комитет за рамковната конвенција за заштита на националните малцинства, коментар за ефективното учество на лицата кои припаѓаат на националните малцинства во културниот, социјалниот и економскиот живот и во јавните работи, усвоено на 27 февруари, 2008 година, ACFC/31DOC(2008)001 достапно на: <http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_fcnmdocs/PDF_CommentaryParticipation_en.pdf> Последно пристапено: 23 октомври.
11. Совет на Европа: Секретаријат за рамковната конвенција за заштита на националните малцинства, советодавен комитет за рамковната конвенција за заштита на националните малцинства: Второ мислење за „Република Македонија“, усвоено на 23 февруари, 2007 година, 9 јули, 2008 година, ACFC/OP/II(2007)002, достапно на: <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/487778032.html>> Последно пристапено: 7 декември, 2011 година.



STUDIO RUM